



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi / Prilazimi / Prilazimi / Prilazimi / Prilazimi	10.11.2022	2	viti / god / year
Organ / Agjencia / Organ / Jedinica / Organ / Jedinica / Organ / Jedinica	IR Prof / IR Prof / IR Prof / IR Prof / IR Prof / IR Prof / IR Prof / IR Prof	Shtojca / Prilog / Prilog / Prilog / Prilog / Prilog / Prilog / Prilog	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHKOL	7008 / 2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.789/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani -anëtarë dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.789/2022 të datës 12.09.2022 të ankuesit me adrese banimi: në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me A.nr.789/2022 të datës 12.09.2022 e parashtruara nga ankuesi

Arsyetim

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Agjencia për Informim dhe Privatësi me datë 16.05.2022 ka shpallur konkursin për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave (RN00009046)” në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo sipas njoftimit të datës 22.08.2022 procedura e lëvizjes brenda kategorisë ka përfunduar pa kandidat fitues.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 12.09.2022 me pretendimet ankimore se nuk ka pranuar përgjigje apo Vendim ndaj ankesës së tij të parashtruar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ndërsa me plotësimin e ankesës të datës 22.09.2022 ka pretenduar se procedura e rekrutimit ka qenë në

kundërshtim me Rregulloren Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për shkak se kandidati për pozitën e konkurruar ka qenë edhe anëtar i Komisionit për Vlerësimet të Lëvizjes Brenda Kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Ndërsa Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Tutje, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ankesës ka vërejtur mungesë të provave të kërkuara nga Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe ndaj të njëjtës përmes kërkesës së datës 25.10.2022 ka kërkuar plotësimin e tyre me prova shtesë të cilat, Këshilli i ka pranuar me datën 28.10.2022 të regjistruar me numrin e protokollit 6558/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.09.2022 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes e-mail me datën 09.09.2022; Plotësim Ankesë e datës 22.09.2022; Njoftimin e datës 22.08.2022 të lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi; Ankesë kundër rezultatit të fazës së vlerësimit për pozitën me nr. Ref. RN00009046 e datës 25.08.2022; E-mail i dërguar nga A.S datës 22.08.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 19.08.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 11.08.2022; E-mail i dërguar nga Ankesa KPMSHCK i datës 19.09.2022; E-mail i dërguar nga S.S i datës 9.09.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 13.09.2022; E-mail i dërguar nga S.S i datës 13.09.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 22.09.2022; Vendim i lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi nr.88/2022, me nr.prot.369, i datës 13.09.2022; Vendim i lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi nr.81/2022, nr.prot.491 e datës 10.08.2022; Shkresë-Rezultatet e Vlerësimit për S.S.; Shkresë- Renditja përfundimtare e kandidatëve lëshuar nga SIMBNJ; Kërkesë për qasje në dokumente drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi e datës 09.09.2022; Shkresë-Rezultatet e verifikimit paraprak 1-2 faqe; Kërkesa për përgjigje në ankesë me nr. Prot.5368/2022 e datës 13.09.2022; Përgjigja në ankesë e lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi e datës 20.09.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 19.08.2022; E-mail i dërguar nga S.S e datës 19.08.2022; E-mail i dërguar nga A.S e datës 22.08.2022; E-mail i dërguar nga S.S e datës 22.08.2022; Pliko e bardhë; E-mail i dërguar nga A.S drejtuar F.G i datës 27.10.2022; Përgjigje në shkresën e datës 25.10.2022 të KPMSHCK me nr.prot.407 e datës 27.10.2022; Konkursi me numër të referencës RN00009046 i datës 16.05.2022; Vendimi me nr.prot.491 i datës 10.08.2022; Lista e aplikantëve; Njoftim i datës 12.08.2022; Vendim me nr.34/2022 i datës 10.06.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve; E-mail i dërguar nga A.S drejtuar S.S i datës 13.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-6 faqe; CV e ankuesit; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filozofik, për me nr.1127 e datës 10.07.2008; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik- Master për me numër 348 e datës 30.04.2014; Letër reference e datës 16.05.2022; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik- Master për me numër 809 e datës 06.02.2017; Letër reference e datës 25.05.2022; Kopja e letërnjoftimit; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë me PN.NR/KR.Br. 2397/2022 e datës 26.05.2022; Formular për Vlerësimin e rezultateve në të nëpunësve Civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale për i datës 18.01.2022; Formular për Vlerësimin e



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e palejuar , sepse**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se në konkursin e datës 16.05.2022 të shpallur nga Agjencia për Informim dhe Privatësi për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave (RN00009046)", ka aplikuar me aplikacionin me numër RAN0005247, ndërsa me datën 15.08.2022 ka mbajtur intervistën me gojë në objektin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, pas të cilës ankuesi është njoftuar përmes e-mail të datës 22.08.2022 se i njëjti ka mbledhur 48.6 pikë dhe se procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në kuadër të Departamentit për Qasje në Dokumentet Publike, përfundon pa kandidatë fitues.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesin përmes e-mailit të datës 22.08.2022 për vlerësimin nga Komisionit Vlerësues dhe për të drejtën e tij për të parashtruar ankesë, dhe po ashtu është konstatuar fakti se Njësia e Burimeve Njerëzore e ka publikuar njoftimin e datës 22.08.2022 se procedura e rekrutimit ka përfunduar pa kandidatë të suksesshëm. Ndërsa, ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e Komisionit Vlerësues pretendon se ka parashtruar ankesë në SIMBNJ/Sistemi informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore me datë 25.08.2022 për të cilën e ka njoftuar Menaxheren e Burimeve Njerëzore edhe përmes e-mailit të datës 13.09.2022. Agjencia për Informim dhe Privatësi-Menaxherja e Burimeve Njerëzore përmes e-mailit me datë 13.09.2022 ka njoftuar ankuesin se në SIMBNJ nuk ka pranuar asnjë ankesë të bashkangjitur lidhur me procesin e rekrutimit dhe sipas pretendimeve në përgjigje të dhënë për Këshillin me datë 28.10.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore thekson faktin se nuk janë përgjigjur në ankesën që ankuesi pretendon për arsye se në sistemin për Menaxhimin e Burimeve njerëzore dhe procedurave të rekrutimit nuk kanë pranuar një ankesë të tillë.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", po ashtu ka analizuar edhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: "Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet", nga rrjedh se kandidatët në procedurë kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në Këshill vetëm në rastet kur të njëjtit i kanë shterë proceduarat e brendshme ankimore, me qëllim që ankesa të bëhet në frymën e nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore se i njëjti ka parashtruar ankesë në SIMBNJ/Sistemi informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 25.08.2022 kundër rezultatit të vlerësimit për procedurën e rekrutimit në të cilën kishte aplikuar, i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me kërkesën për prova shtesë ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit dhe të njëjtit kanë ofruar shkresën e marrë nga gjendja teknike e linkut të menaxhimit elektronik të procesit të rekrutimit hrms.rks-gov.net dhe është konstatuar fakti se në sistem ankuesi nuk ka arritur të ngarkojë apo ta procedoj ankesën për të cilën pretendon, ngase përveç tjerash nga kjo shkresë vërehet fakti se procedura konfirmohet e përfunduar dhe sikurse të kishte ankesë të ngarkuar, sistemi në mënyrë automatike nuk do ta lejonte përfundimin e procedurës deri në zgjedhjen e ankesës, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e pa lejueshme ngase nuk plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj", ngase është konstatuar fakti se ankesa e ankuesit e datës 25.08.2022 për të cilën pretendon se e ka parashtruar, nuk mund të argumentohet fakti nëse e njëjta është ngarkuar në sistem apo nëse sistemi e ka pranuar, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore mbetet pranë përgjigjes së përsëritur në Këshill të datës 28.10.2022 se të njëjtit nuk kanë pranuar ankesë në sistem, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ankesën e ankuesit e ka hedhur poshtë si të palejueshme sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ngase konstatohet fakti se ankuesi nuk ka arrit të parashtojë ankesë të brendshme dhe se ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.789/2022

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve;
- Sekretarit të Përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së